



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 454 Prot.

Tiranë, më datë 24.08.2023

**VENDIM**  
**Nr. 471, datë 24.08.2023**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 24.08.2023:

**VENDOSI:**

1. Mosmiratimin e vijimit të procedurës së legalizimit të objektit informal me vetëdeklarues Z. Nazmi Hafizi, Z. Alfred Vokri, Brenda kufirit të Zonës Arkeologjike “A”, Lezhë, për arsye se:
  - a) Objekti informal, cënon integritetin e pasurive kulturore të paluajshme të grupuara, Zonë Arkeologjike “A”, sipas VKM Nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje” Kreu II, pika 15 ë);
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Elva MARGARITI**

**SEKRETAR**  
**Klesta QIRICI**

Klesta  
Qirici

Digitally signed by  
Klesta Qirici  
Date: 2023.08.25  
13:33:50 +02'00'

Elva  
Margariti

Digitally signed by Elva  
Margariti  
Date: 2023.08.25  
13:42:27 +02'00'